

1 E premte, 3 dhjetor 2021

2 [Deklaratë hyrëse - Mbrojtja e Gucatit]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Gucati hyn në sallë]

5 [I akuzuari Haradinaj merr pjesë përmes

6 videolidhjes]

7 --- Seanca fillon në orën 09.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

9 Mirëmëngjesi, të gjithëve. Mirë se keni ardhur.

10 Zonja Sekretare, ju lutem thërrisni çështjen.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

12 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i

13 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Prania e

15 palëve.

16 Z. REES: [Përkthim] Nuk kemi ndryshim.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kemi ndryshim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sot do të

19 dëgjojmë deklaratën hapëse të Mbrojtjes për zotin Hysni Gucati

20 në pajtim me rregullin 126 dhe 127 të Rregullores.

21 Përpara sesa të fillojmë, për publikun, dua të shprehem

22 që Trupi Gjykses mori vendimin për organizimin e konferencës

23 për përgatitjen e Mbrojtjes dje.

24 Duke pasuar parashtrimet e zotit Rees, Trupi Gjykses

25 planifikoi këtë seancë të ditës së sotme, për datën 3 dhjetor

1 2021.

2 Trupi Gjykses kujton se në pajtim me rregullin 26,
3 paragrafi 1, deklaratat hapëse do të bëhen me gojë dhe duhet
4 të jenë të kufizuara në një vështrim të përgjithshëm në parim
5 për çështje të cilat mbulohen. Ato duhet të japin një shpjegim
6 konciz të provave të cilat do të kenë ndikim mbi çështjen.
7 Prezantimi i provave për zotin Gucati do të filloj më datën 6
8 dhjetor 2021.

9 Zoti Rees, fjalën e keni ju tani.

10 Z. REES: [Përkthim] Sipas ligjit, ky institucion është
11 një institucion i Republikës së pavarur dhe sovrane të
12 Kosovës. Është e drejtë që populli i Kosovës të presë që ky
13 institucion të veprojë si i tillë.

14 Republika moderne e Kosovës i cakton vlerën më të lartë
15 në hierarkinë e vlerave lirisë së shprehjes, fjalës dhe të
16 opinionit. Këto liri janë fituar nga brezi i Hysni Gucatit
17 duke sakrifikuar jetën dhe gjakun e tyre. Në njohje të kësaj
18 sakrifice, Republika moderne e Kosovës kërkon që institucionet
19 e veta të jenë të hapura dhe transparente, që rrezja e dritës
20 të ndriçojë të gjithë katër cepat e organeve administrative
21 dhe gjyqësore.

22 Ligji për klasifikimin e informacionit në Kosovë është i
23 qartë. Klasifikimi i informacionit si i kufizuar ose
24 konfidencial ose sekret, nuk duhet të përdoret si instrument
25 për të fshehur "shkeljet e ligjit, abuzimin me detyrën,

1 mungesën e efikasitetit ose gabimin dhe nuk duhet të përdoret
2 për të parandaluar cenimin e një personi, organi publik, ose
3 organizate".

4 Ditët kur organet apo autoritet mund të përdornin shumë
5 shpejt një perde sekreti, ose fizike ose virtuale, ndërmjet
6 vetes së atyre por gjithashtu edhe me galerinë publike të
7 njerëzve të Kosovës, të popullit të Kosovës, kurdoherë kur
8 autoritetet kërkonin që të shmangnin, le të themi, kontrollin
9 publik, besoj që duhet të jenë të kufizuara në të shkuarën e
10 largët. Për të qenë i sinqertë, për ata të cilët dyshojnë siç
11 bën edhe Prokurori i Specializuar, atëherë shikoni punën tonë
12 gjyqtarë dhe, ndërkohë që ne po kërkojmë që të kontrollojmë se
13 çfarë bëhet nga puna e personave të dyshuar duke dhënë vetëm
14 versione të censuruara dhe të pastruara për publikun.

15 Për më tepër, e tashmja dhe e ardhmja e Kosovës duhet të
16 jetë një aktualitet ku drejtësia ofrohet për të gjithë dhe jo
17 vetëm për disa.

18 Prokurori i Specializuar, në deklaratën e vet hapëse,
19 foli vetëm për këto vlera më të rëndësishme në mënyrë
20 sipërfaqësore.

21 "Debatet e ashpra për sa i takon çështjeve të rëndësishme
22 publike përbëjnë një shenjë - më falni - do ta filloj edhe një
23 herë.

24 "Debatet e shumta për çështjet e rëndësishme publike janë
25 një shenjë e shoqërisë së shëndetshme dhe duhet të forcohen më

1 tej dhe të mos shtypen" dhe këtë e ka pranuar Prokurori i
2 Specializuar. "Është në rregull që të thuash se çfarë nuk
3 pëlqeni sa i takon kësaj Gjykate dhe nuk ka problem që të
4 thoni gjithashtu edhe pse nuk e pëlqeni këtë Gjykatë" ka
5 vijuar ai më tej. "E gjithë kjo është pjesë e një shoqërie të
6 lirë", po ashtu ra dakord ai.

7 Fjalë të tilla të arsyeshme në dukje nga Prokurori i
8 Specializuar nuk duken sikur shtrihen edhe për zotin Gucati
9 dhe të bashkakuzuarin tjetër. Për zotin Gucati, fjalët e tij
10 janë kthyer kundër vetes nga Prokurori i Specializuar, i cili
11 e etiketoi zotin Gucati si "një oponent të shprehur dhe të
12 ashpër" të këtij institucioni sikur pavarësisht nga ajo çfarë
13 kishte thanë më përpara sa i takon lirisë së shprehjes, kjo në
14 vetvete të përbënte një vepër penale.

15 Provat e bëjnë të qartë dhe e parashtrojmë këtë gjë dhe
16 do ta shohim që Prokurori i Specializuar kërkon që të marrë
17 dhe të përzgjedhë ata të cilët ai i konsideron si me vlerë për
18 të gëzuar të drejtën e lirisë së shprehjes. Ndërkohë që zoti
19 Gucati një oponent i shprehur, i njohur i ZPS-së nuk duket të
20 jetë njëri prej tyre. Zoti Gucati vërtet është shprehur sa i
21 takon shqetësimeve që kanë të bëjnë me këtë institucion. Ai ka
22 qenë dhe vazhdon të jetë të ketë të drejtë, pra, të shprehet
23 lidhur me të. Ai ka përcaktuar arsyet se pse ka shqetësime
24 lidhur me këtë institucion. Ai ishte, më përpara dhe është
25 edhe sot e kësaj dite, në pozicion për ta bërë një gjë të

1 tillë.

2 Do t'i kthehem këtyre shqetësimeve më të gjera pas pak
3 kohe sepse ato janë shqetësime të cilat janë ndarë edhe nga
4 persona të tjerë, pra, janë të përbashkëta edhe me persona të
5 tjerë.

6 Një çështje për të cilën është shprehur zoti Gucati është
7 që Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk ndjek drejtësinë për
8 të gjithë, por vetëm për ca. Pretendimi i Prokurorit të
9 Specializuar, në deklaratën hapëse të Prokurorisë, se kjo
10 Gjykatë duhet të jetë një Gjykatë, e cila shtytet nga
11 viktimat, cenohet nga veprimet e zyrës së vet, e cila ndjek jo
12 rrugën e dymëve të çdokujt që mund të kenë prova për
13 kriminelë, por mandatin apo agjendën e vet.

14 Është arrogante dhe e pasaktë në masa të barabarta për
15 ZPS-në që të prezumojë që drejtimi që ka marrë ajo për të
16 ndjekur këtë agjendë është e njëjtë në të gjitha aspektet e
17 mundshme ashtu siç drejtimi që udhëtohet nga rruga e drejtë e
18 drejtësisë.

19 Le të shohim provat. Prova të cilat i kemi dëgjuar deri
20 më tash dhe që i kemi marrë në kuadër të kësaj çështjeje.
21 Prova të cilat kanë të bëjnë rreth shqetësimeve që janë ndarë
22 edhe nga të tjerët dhe në fakt dhe që janë botuar nga persona
23 të tillë online dhe të cilat janë të dukshme dhe janë të
24 pranishme online edhe sot e kësaj dite.

25 Ne kemi parë provën materiale P0074 dhe P0074-ET që është

1 titulli i gazetës NewBorn, "Skandaloze: Dhomat e Specializuara
2 bashkëpunojnë edhe me Ministrinë e Brendshme Serbe për të bërë
3 organizimet për dëshmitarët për të dhënë dëshmitë e tyre
4 kundër UÇK-së".

5 Artikulli vijon më tej:

6 "Provrat të reja tregojnë për një proces skandaloz të
7 kryer nga Dhomat e Specializuara lidhur me personat e akuzuar
8 të cilët janë anëtarë të UÇK-së. Një dokument i gjetur nga
9 gazeta NewBorn tregon që kjo Gjykatë ka bashkëpunuar me MUP-in
10 serb në mënyrë që të sigurojë dhe që të gjejë sa më shumë
11 dëshmitarë që të jetë e mundur kundër atyre që janë të akuzuar
12 dhe që janë anëtarë të UÇK-së".

13 Ne pamë gjithashtu edhe provën materiale P00124 dhe
14 P0024-ET, përkthimin. Sërish kjo provë kishte si titull:
15 "Skandali i Dhomës së Specializuar: Ajo ka bashkëpunuar me
16 ushtrinë serbë, me oficerë të ushtrisë serbe, të cilët kanë
17 qenë po aktivë gjatë kohës së Millosheviçit".

18 Artikulli vijoi më tej:

19 "Dokumente të tjera flasin për bashkëpunimin e Dhomave të
20 Specializuara me zyrtarë serbë të cilët kanë qenë në detyrë
21 aktive gjatë kohës së kasapit të Ballkanit, Sllobodan
22 Millosheviçit. Dushan Keranoviçi dhe Veljko Lojanica të cilët
23 janë dy emra të oficerëve serbë të cilët kanë qenë të
24 pranishëm në disa prej masakrave më makabre të zhvilluara në
25 Kosovë nga regjimi i Millosheviçit. Gazeta NewBorn i ka marrë

1 dokumentet duke treguar që oficerët serbë janë kontaktuar nga
2 Dhomat e Specializuara në mënyrë që të jepnin dëshmi kundër
3 UÇK-së dhe anëtarëve të saj”.

4 Kush do të kërkojë drejtësi për viktimat e atyre
5 masakrave makabre, në të cilët këto dy oficerë serbë ishin të
6 pranishëm dhe aktivë? Jo ZPS-ja, e cila në fakt në vend të
7 kësaj kërkon bashkëpunimin e tyre në mënyrë që të përmbushë
8 agjendën e vet.

9 Brenda të njëjtave prova materiale, ne kemi parë edhe një
10 tjetër artikull. Në këtë rast artikulli kishte titullin:

11 “Komandanti i policisë, ish-komandanti i policisë së Gjakovës,
12 Milan Stojanoviç, bashkëpunëtor i Dhomave të Specializuara”.

13 “Edhe pse ata zgjohen çdo ditë në panik në mënyrë që të
14 dëgjojnë lajme për të dashurit e tyre”, shkruan gazetari,
15 “kanë kaluar mbi dy dekada dhe asnjë informacion nuk është
16 dhënë rreth personave të zhdukur të Gjakovës. Megjithatë,
17 duket se ish-komandanti i policisë i Gjakovës gjatë regjimit
18 të Millosheviçit, Milan Stojanoviç, është një bashkëpunëtor i
19 ngushtë i Dhomave të Specializuara, pavarësisht faktit se ai
20 është përgjegjës për masakrën e Mejës në Gjakovë. Ish-
21 komandanti Stojanoviç po bashkëpunon me Dhomat e Specializuara
22 në mënyrë që të gjejë prova kundër ish-ushtarëve të UÇK-së.
23 Gazeta NewBorn e ka marrë një dokument që konfirmon
24 bashkëpunimin e Stojanoviçit me Dhomat e Specializuara”.

25 Kush do të kërkojë drejtësi për ata persona në Gjakovë të

1 cilët janë zhdukur nën rendin e Milan Stojanoviçit? Jo ZPS-ja,
2 e cila në vend që të bëjë këtë gjë bashkëpunon në mënyrë që të
3 ndjek agjendën e vet me persona të tillë. Kush do të kërkojë
4 drejtësi për ata persona të cilët janë vrarë në masakrën e
5 Mejës nën komandën e Milan Stojanoviçit? Jo ZPS-ja, e cila në
6 vend të kësaj gjëje kërkon bashkëpunimin me të për të ndjekur
7 agjendën e saj.

8 Ne pamë gjithashtu provën materiale në video me numër
9 identifikimi P00123 me pamje, me fotografi të varrezave në
10 Mejë, po ashtu dëgjua narracione në datës 27 prill. Ku 27
11 prilli shënjon ditën ku 376 civilë, përfshirë këtu gra dhe
12 fëmijë, janë vrarë në Mejë. Fëmijë nga një vjeç e gjysëm, si
13 edhe gra, fillimisht u ekzekutuan dhe më pas u dogjën brenda
14 një shtëpie nga forcat serbe. Dhomat e Specializuara kërkuan
15 ndihmën dhe bashkëpunimin e komandantit të milicisë në Gjakovë
16 në atë kohë, Milan Stojanoviç, kundër UÇK-së dhe ndërkohë që
17 pamë imazhet ne pamë të gjithë edhe nëntitullin "Personi
18 kryesor përgjegjës për masakrën e Mejës, Stojanoviç, personi i
19 cili duhet të jetë në burg, po bashkëpunon me Dhomat e
20 Specializuara".

21 Kush do të gjejë drejtësinë për ata 376 civilë, përfshirë
22 gra, fëmijë dhe foshnje, të cilët u vranë, u ekzekutuan dhe u
23 dogjën brenda një shtëpie nga forcat nën kontrollin e Milan
24 Stojanoviçit? Jo ZPS-ja, e cila në vend të kësaj kërkon
25 bashkëpunimin me këtë person për të ndjekur agjendën e saj.

1 Ne pamë provën materiale P00128 dhe versionin e përkthyer
2 me numër identifikimi P00124-ET, me titullin "Dhomat e
3 Specializuara bashkëpunojnë me një person të deklaruar në
4 kërkim nga Interpoli për krime lufte në Kosovë në mënyrë që
5 gjejnë prova kundër UÇK-së. Ka prova të reja lidhur me punën e
6 Dhomave e Specializuara dhe bashkëpunimin e vet me personat e
7 akuzuar për krime lufte", shkruan gazetari. "Gazeta NewBorn ka
8 siguruar një dokument i cili tregon që një person i cili është
9 deklaruar i kërkuar nga Interpoli për krime lufte në Kosovë
10 duket se është dëshmitar kundër UÇK-së në Dhomat e
11 Specializuara. Në vitin 2005, ndërkohë që vazhdonte gjykimi
12 kundër kasapit të Ballkanit Slllobodan Millosheviç del në
13 kamera fytyra e një shqiptari të Kosovës Muharrem Ibraj. Ai
14 ishte dëshmitar i Millosheviçit. Muharrem Ibraj vjen nga një
15 prej zonave ku janë kryer krimet më të tmerrshme nga aparati
16 shtetëror serb dhe më pas shkon në Hagë që të mbrojë Slllobodan
17 Millosheviçin", thotë gazetari, "Muharrem Ibraj akuzohej për
18 krime dhe përdhunime gjatë luftës në Kosovë. Në mënyrë të
19 ngjashme Ibraj është një prej 17 personave që kërkohet nga
20 Interpoli për krime lufte dhe është i vetmi person që ka etni
21 shqiptare". Më pas ofrohet një listë e 17 serbëve dhe një
22 kosovari që kërkohen nga Interpoli për krime në Kosovë, disa
23 prej emrave të të cilëve ne do t'i përmendim më pas.

24 Kush do të gjejë drejtësinë për viktimat e krimeve, të
25 përdhunimeve të kryera nga Muharrem Ibraj gjatë luftës në

1 Kosovë? Jo ZPS-ja, e cila në vend të kësaj kërkon
2 bashkëpunimin për të ndjekur agjendën e vet.

3 Ne pamë provën materiale P00125 dhe përkthimin e saj me
4 numër identifikimi P00125-ET3 dhe titullin "Skandaloze:
5 Gjykata Speciale kërkon materialin inkriminues për Adem
6 Jasharin".

7 "Gjykata Speciale i ka kërkuar Zyres Serbe të Prokurorisë
8 materiale inkriminuese për Adem Jasharin 17 vjet pas vdekjes
9 së tij", botohet në gazetë. "Në mars të vitit 1998, pas disa
10 ditësh rezistencë në Prekaz, komandanti Adem Jashari edhe 60
11 anëtarë të familjes së tij u vranë. Sulmi i njëjtit të posaçme
12 të Serbisë mbi familjen Jashari në Prekaz çoi në vrasjen
13 brutale të Adem dhe Hamez Jashari dhe familja e tyre u dënua
14 nga Amnesty Internaciona. Masakra kundër familjes Jashari në
15 Prekaz, si shumë masakra të tjera, u krye nga forcat të
16 rregullta policore, ndërmjet të cilëve edhe 21 vjet në vonë,
17 askush nuk ka mbajtur përgjegjësi për atë çfarë ka ndodhur
18 edhe pse emrat e atyre që janë në zinxhirin e komandës janë të
19 njohur duke filluar këtu nga polici deri tek presidenti
20 Slllobodan Millosheviç. Nuk është bërë asnjë përpjekje nga
21 drejtësia ndërkombëtare për të gjykuar kriminelët serbë dhe
22 për të ofruar drejtësi për vrasje të tilla barbare.

23 "Megjithatë, më datë 11 qershor 2015 e kundërta ndodhi,
24 ndërmjet mijërave dokumenteve të rrjedhura nga Gjykata
25 Speciale ishte edhe një letër në të cilën Prokurori David

1 Schwendiman i kërkonte ish-Prokurorit të luftës së Serbisë
2 Vladimir Vukseviç që t'i jepte atij dokumente për Adem
3 Jasharin. "Në letrën e vet", vijon artikulli "Schewendiman
4 shkruan se "në pajtim me koordinimin në vijim dhe pas një
5 takimi të organizuar më datë 1 qershor 2015, ai i kishte
6 kërkuar zyrës së Prokurorisë për Krimet e Luftës së Serbisë që
7 t'i jepnin atij kopje të rasteve dokumenteve të cilat
8 lidheshin me terrorizëm të grupeve të armatosur të organizuara
9 të kryera nga shqiptarët e Kosovës në periudhën 1981 deri në
10 1999 duke përmendur specifikisht edhe emrin e Adem Jasharit.
11 Ai, së bashku me 60 anëtarë të familjes së tij, janë vrarë në
12 mënyrë çnjerëzore në shtëpinë e tyre posaçërisht nga forcat
13 serbe 17 vite më përpara sesa kjo kërkesë për materialin
14 inkriminues të ndodhte".

15 Dhe më tej në gazetë thuhet, citohet që:

16 "Që unë kërkoj në qoftë se është e mundur që
17 dokumentacioni i parë të jepet dhe do të duhet që të lidhet me
18 çështjen K me numër 139/96 gjykimi i K, numër 37/97 i Gjykatës
19 së Prishtinës kundër individëve të mëposhtëm, duke përcaktuar
20 me emra", dhjetë individë të ndryshëm, përfshirë këtu edhe
21 Adem Jasharin.

22 Gazeta vijon më tej:

23 "Shteti i Serbisë ka kryer mbi 400 masakra çnjerëzore
24 kundër civilëve shqiptarë në Kosovë. Ajo ka vrarë në mënyrë
25 mizore rreth 13.000 civilë të pafajshëm, ndërmjet të cilëve

1 dhe rreth 1.300 fëmijë. Forcat e policisë serbe dhe ushtarake
2 serbe kanë përdhunuar mbi 20.000 gra shqiptare dhe kanë dëbuar
3 mbi një milion shqiptarë nga shtëpitë e tyre. Në përpjekjet e
4 tyre për spastrimin etnik, ata kanë djegur dhe kanë
5 shkatërruar pjesën më të madhe të pronave shqiptare”.

6 Artikulli përfundon duke thënë:

7 “Që kërkesat e drejtësisë ndërkombëtare për të hetuar
8 viktimat e masakrave mizore nga rrëgjimi serb, krimet të cilat
9 nuk janë zgjidhur asnjëherë, janë fyerje dhe padrejtësi për
10 vetë viktimat, për familjet e tyre dhe për popullin shqiptar”.

11 Kush do të gjejë drejtësi për ata 60 viktima të familjes
12 Jashari të vrarë në Prekaz? Jo ZPS-ja, e cila në vend që të
13 bëjë këtë gjë ju drejtohet këtyre agjencive, agjencive që kanë
14 qenë përgjegjëse për masakra, që të bashkëpunojnë me të për të
15 ndjekur agjendën e vet të ZPS-së.

16 Gjatë çështjes sonë të Mbrojtjes, ne do të parashtrojmë
17 prova të tjera që kanë të bëjnë me emra të tjerë që tregojnë
18 që ZPS-ja ka kërkuar bashkëpunim nga ata, duke përfshirë
19 Nebojsa Trajkoviç, i njohur ndryshe ai Lutka, zëvendësshefi i
20 njohur Glogovcit në njësinë OUP të njësisë për punët e
21 brendshme të ministrisë së Sllobodan Millosheviçit për
22 çështjet e brendshme. Glogovc, që njihet ndryshe si Drenas
23 tani, ka qenë vendi ku kanë ndodhur ekzekutime të shumta,
24 rrahje dhe vjedhje të forcave të sigurisë serbe në pranverë të
25 vitit 1999. Dhe zoti Trajkoviç është etiketuar publikisht nga

1 Human Rights Watch si organizuesi kryesor i shpopullimit të
2 detyruar të fshatit Drenas në Maj të vitit 1999.

3 Ne do të japim gjithashtu prova për Bogdan Periç, një
4 individ i cili është identifikuar publikisht nga BE-ja dhe
5 vendimi i Këshillit të BE-së me numër 1999/319/SFSP që zbaton
6 pozicionin e përbashkët 1999/319/F, që përcakton masa shtesë
7 kufizuese kundër Republikës Federale të Jugosllavisë duke e
8 etiketuar këtë zotëri, zotin Periç, si ish-kryetarin e
9 Gjilanit dhe si bashkëpunëtor i Slllobodan Millosheviçit duke
10 e ndaluar atë si një person i cili ka qenë mbështetës dhe që
11 ka ndihmuar regjimin e presidentit Millosheviç.

12 Ne do të paraqesim prova për Branisllav Radiç, ose
13 Branisllav Rakiç siç e tha ndryshe zonja Pumper gjatë dhënies
14 së provave të saj, pjesë e mbrojtjes civile në Ferizaj në
15 vitin 1999 kur populli i Kosovës ka qenë objekt i dëbimit
16 masiv në prill të 1999. Radiç ose Rakiç është një person i
17 cili kërkohet policia kosovare për krime por ndërkohë kërkohet
18 për bashkëpunim nga ZPS-ja.

19 Çështje të cilat kanë të bëjnë me shqetësimet e shprehura
20 në këto artikuj, në këto dokumente të cilat janë cituar nga
21 gazeta NewBorn, nga Top Channel, nga ATK-ja, nga RTK-ja dhe
22 transmetues të tjerë vetëm kanë dalë në dritë për shkak të
23 faktit që shtypi kishte qasje në dokumente të cilat sugjerohen
24 nga ZPS-ja tani se duhet të kishin qëndruar jashtë vëmendjes
25 dhe syrit të medias.

1 Gazetarë të tjerë individual kanë ndarë të njëjtat
2 shqetësime. Në kuadrin e provës materiale P11-ET, politikani
3 dhe gazetari Berat Buzhala ka shprehur shqetësimet e veta. Ai
4 thotë:

5 "Unë kam votuar për formimin e Dhomave të Specializuara,
6 por nuk do ta kisha bërë të njëjtën gjë, nuk do të kisha
7 votuar për të. Milovan Dreçun është bashkëpunëtor serb me
8 Tribunalin e Hagës dhe unë vetë jam mjaftueshëm në moshë për
9 të ditur se kush është Milovan Dreçun.

10 "Kjo nuk është mënyrë për të gjetur drejtësinë. Drejtësia
11 nuk mund të gjendet, nuk mund të ofrohet me ndihmën e aparatit
12 të Slllobodan Millosheviçit".

13 Vetë presidenti Vuçiç ka pranuar që forcat e sigurisë
14 serbe kanë vrarë civilë serbë me synimin që t'i hedhin fajin
15 shqiptarëve dhe ai i referohet vrasjes së civilëve nga forcat
16 e sigurisë serbe. Ai vazhdon:

17 "Si mundeni ju jo vetëm të bashkëpunoni por të pretendoni
18 të vini drejtësi në vend për krimet e luftës në Kosovë me të
19 njëjtët organe të cilët kanë vrarë civilët e tyre? Për mua,
20 kjo është plotësisht e papranueshme. Kjo shtrembëron
21 realitetin për të cilën ky proces nisi.".

22 Në të njëjtën mënyrë sesi Prokurori i Specializuar përbuz
23 shprehjen e këtyre shqetësimeve nga Hysni Gucati, Prokurori i
24 Specializuar lëvdon median në Kosovë, duke e siguruar
25 drejtpërdrejtë dëshmitarin civil Halil Berisha se ai nuk

1 kishte bërë asgjë të keqe.

2 Në vlerësimin e qartë të ZPS-së, zoti Berisha nuk kishte
3 kryer asnjë krim. Dhe ne, plotësisht, pajtohemi me këtë.
4 Megjithatë, merrni parasysh dëshminë e tij krahasoheni
5 qëndrimin e tij me atë të Hysni Gucatit. Në fund të
6 konferencës së parë për shtyp, zoti Berisha tha se ai dhe
7 kameramanët e tij morën pamje të dokumenteve, i filmuan ato.
8 Ndryshe nga zoti Gucati, ai krijoi kopje të këtyre
9 dokumenteve.

10 Organizata e medias, inFokus, e transmetoi përmbajtjen e
11 konferencës së shtypit në median sociale, duke i kushtuar kohë
12 fjalëve të thëna nga zoti Gucati dhe i bashkakuzuari i tij se
13 ZPS-ja sulmoi dhe kritikoi atë. Ai, zoti Berisha, kërkoi që
14 t'i merrte dokumentet. Ai donte t'i merrte të gjitha këto
15 dokumente, t'i shikonte në formën e tyre të plotë dhe të
16 paredaktuar dhe ai mori, në fakt, rreth një mijë faqe duke
17 bërë një shqyrtim të parë të përmbajtjes së tyre në zyrat
18 qendrore në OVL UÇK-së. Ai fizikisht i hoqi dokumentet nga
19 zyra dhe i shpuri në zyrat e veta tek gazeta inFokus ku,
20 sikurse dhe zoti Gucati, ai i vuri dokumentet në dispozicion
21 të të tjerëve të gazetarëve profesionistë, siç kishte bërë
22 edhe zoti Gucati, në zyrat e zotit Berisha, ku ai diskutoi për
23 përmbajtjen e plotë dhe të paredaktuar të tyre me
24 bashkëredaktorët e vet, me katër prej tyre. Këto dokumente ai
25 jua vuri në dispozicion katër personave pa asnjë redaktim. Dhe

1 si zoti Gucati, zoti Berisha gjithashtu u kujdes që të
2 krijoheshin më shumë dokumente në zyrat e inFokus, duke i
3 filmuar ato. Kopjet e dokumenteve që ai, kameramanët e tij dhe
4 bashkëredaktorët e tjerë bënë, u krijuan në formë dixhitale
5 dhe nuk janë marrë më nga ZPS-ja. Në fakt, e vërteta është se
6 ZPS-ja nuk çau kokën që të t'i kërkonte, t'i merrte. Nuk
7 treguan asnjë interes për t'i marrë ato dokumente, pavarësisht
8 nga artikulli i botuar nga inFokus, duke e bërë ekzistencën e
9 këtyre dokumenteve që ishin në zotërim të inFokus të qarta për
10 t'i parë të gjithë.

11 Ndryshe nga zoti Gucati, zoti Berisha dhe
12 bashkëredaktorët e tij botuan kopje të dokumenteve në internet
13 që t'i shikonin të gjithë ku ato janë edhe sot. ZPS-ja nuk i
14 kërkoi inFokusit kurrë që t'i hiqte ato artikuj dhe nuk ka
15 treguar asnjë lloj interesi që të hiqen ato artikuj edhe pas
16 pranisë së tyre në internet, pasi morën vesh se ato ishin aty
17 në internet nëse nuk e kishin ditur më parë.

18 Zoti Berisha raportoi se dosjet përmbanin emra serbë,
19 shqiptarë, romë dhe ashkali, diçka për të cilën ZPS-ja e
20 kritikoi zotin Gucati që e ka thanë. Ai raportoi se
21 bashkëpunimi midis hetuesve të specializuar dhe dëshmitarëve
22 dhe zyrtarëve serbë ishin të qarta në ato dokumente dhe TFHS-
23 ja ishte në kontakt me Vladimir Vukçeviç, ish-prokuror i
24 krimeve të luftës, por edhe me Milovan Dreçunin, shefi i
25 grupit të punës.

1 Ishte në interes publik për ta bërë këtë, tha zoti
2 Berisha, sepse, citoj në fjalët e tij, "këto persona ishin
3 zyrtarë të lartë serbë dhe ishin persona të njohur nga pjesa e
4 popullit të Kosovës për shkak të deklaratave të tyre. Pra, siç
5 thuhet në dokumente, ne e gjykuam të dobishme t'i botonim ato
6 dhe të vinim në dukje identitetin e tyre".

7 Ai i citoi drejtpërdrejtë nga letrat e Kwai Hong Ip e
8 TFHS-së dërguar Vukçeviçit ku ishte bashkëngjitur një listë
9 personash që TFHS-ja do të intervistonte. Zoti Berisha i
10 redaktoi emrat në listë kur i botoi artikullin online, por
11 vetëm mbasi i kishte treguar listën e paredaktuar kolegëve të
12 inFokus.

13 Më tej zoti Gucati, zoti Berisha botuan një letër të
14 Komitetit Parlamentar Serbë për Kosovën dhe Metohinë, siç e
15 quajnë ata, dërguar TFHS-së, me datën 17 nëntor 2015, kësaj
16 here duke e botuar letrën të plotë. Mund të pyesni përse? E
17 pyetëm përse. Dhe ai u përgjigj: "Ka shumë arsye për këtë. Një
18 nga arsye për këtë është që çdo qytetar i Kosovës lindur
19 përpara 1996 apo 1995, ata i njohin i dinë krimet e kryera në
20 Kosovë nga serbët dhe pavarësisht nga fakti se Kosova tani
21 është një komb i pavarur këtu teksti përdorë fjalën "Kosovë
22 dhe Metohi", që nuk është termi i saktë. Dhe këto terma janë
23 përdorur në një dokument apo një deklaratë të zyrtarëve serbë
24 dhe ky dokument pretendon krime të kryera nga shqiptarët.
25 Ishte në interesin publik ta dinin këtë".

1 Duke ndarë këto shqetësime të ndara nga RTK-ja, zoti
2 Berisha publikoi një artikull ku fliste sesi Gjykata Speciale
3 kishte kërkuar prova nga Serbia kundër Adem Jasharit. Atë e
4 pyetën se përse e bëri këtë, dhe ai shpjegoi:

5 "...nuk është përmendur kurrë se do të kërkohej dëshmi
6 ndaj heroit të Kosovës, Adem Jasharit. Dhe kur ne e pamë këto
7 në këto dokumente menduam se ishte në interesin publik ta
8 dinte sepse Adem Jashari u vra nga forcat serbe. Dhe unë besoj
9 se qytetarët e Kosovës prisnin të mblidheshin prova kundër
10 atyre që vranë Adem Jasharin dhe jo për vetë Adem Jasharin".

11 Ai citoi gjerë e gjatë nga ajo letër e David Schwendiman
12 dërguar Vukçeviçit që kërkonte atë provë. Ai vijon:

13 "Adem Jashari dhe mbi 50 anëtarë të familjes së tij,
14 përfshirë foshnje, u masakruan forcat serbe. Pra ne, si
15 qytetarë, por dhe si gazetarë njëkohësisht, presim që të
16 mblidhen prova kundër atyre që kryen atë masakër". Dhe jo
17 kundër viktimave të saj.

18 Më tej zoti Gucati thotë, ai ka futur kopje në internet,
19 në sistemin inFokus, ku ato ishin aty për të gjithë ata që
20 punonin aty në inFokus. Dhe inFokus vazhdon të botojë të
21 njëjtën gjë në uebsajtin e vet. Ai dha një shpjegim prekës se
22 përse ishte në interesin e publikut të raportonte që inFokus
23 vazhdonte të publikonte dokumente për provat që do të jepnin
24 ish-oficerët e policisë serbe.

25 "...kjo është në interesin publik. Mbase unë jam i ri në

1 moshë, por edhe unë e kam përjetuar luftën. Unë isha gjashtë
2 vjeç gjatë luftës. Dhe në atë kohë, unë, familja ime dhe
3 qytetarë të tjerë u detyruan të largoheshin nga shtëpia,
4 banesa jonë dhe na detyruan të shkonim në Shqipëri. Si një 6-
5 vjeçar duhej të ecja në këmbë drejt Shqipërisë pa ushqim, pa
6 ujë dhe forcat serbe kishin vendosur kufoma të njerëzve të
7 vdekur në rrugë. Dhe për mua, si një 6-vjeçar, kjo ishte e
8 tmerrshme.

9 "Është një temë që është diskutuar çdo ditë në pjesën
10 tonë të botës. Prandaj dhe ne menduam se kjo ishte në
11 interesin e publikut, pra, të raportonim për këtë çështje
12 ishte në interesin e publikut".

13 InFokus dhe zoti Berisha vetë, nuk i dhanë ZPS-së ndonjë
14 kopje dixhitale të dokumenteve që kishin mbajtur. Për të qenë
15 të drejtë, hetuesit e ZPS-së nuk i kanë kërkuar dhe nga kjo
16 mund të nxjerrët se nuk donin t'ia dinin për to.

17 Në 16 shtator 2021, zoti Berisha vazhdoi të publikonte
18 imazhe të reja të dokumenteve, kësaj here një kopje të plotë
19 të paredaktuar të një letre me titull "Kërkesë koordinim Nr.
20 26", prapë drejtuar zoti Vukçeviç nga Kwai Hong Ip. Edhe pse
21 nuk e botoi online listën e dëshmitarëve bashkangjitur
22 kërkesës, zoti Berisha kishte dhënë qasje në atë listë, të
23 paredaktuar, kolegëve të tij gazetarë, ekipit editorial në
24 zyrat e inFokusit.

25 Dhe ai në të njëjtin artikull botoi një kopje të plotë të

1 një letre me titull "Kërkesë për koordinim Nr.120" drejtuar
2 përsëri zotit Vukçeviç, e cila thoshte se ishte dhënë
3 informacion [nga] Dushan Dragoviç i MUP-it në Jagodinë gjatë
4 tre viteve të shkuara.

5 E pyetën se pse e bëri këtë dhe ai tha. "Dihet publikisht
6 se dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, anëtarët e MUP-
7 it serb vazhduan të ishin të pranishëm në Kosovë dhe të ishin
8 aktivë në Kosovë në mënyrë të paligjshme, pra, kjo ishte në
9 interesin e publikut".

10 Po e përsëris, se ZPS-ja thekson se zoti Berisha nuk ka
11 bërë asgjë të keqe dhe Mbrojtja pajtohet me gjithë zemër me
12 këtë. Çështja që fshihet mbas shqetësimeve të zoti Berisha,
13 siç i ka shprehur në këto artikuj, dolën në dritë për shkak se
14 zoti Berisha kishte qasje në dokumentet që ZPS-ja thotë, në
15 fakt, duhet të kishin mbetur të fshehta dhe të mos ishin
16 nxjerrë në dritën e diellit.

17 Po ju kujtoj fjalët e Prokurorit të Specializuar që i
18 bëri në fillim, "debati i gjallë për çështje me interes publik
19 duhet të nxitet dhe jo të shtypet. Është në rregull të thuash
20 sepse nuk të pëlqen Gjykatë, nuk ka problem që nuk të pëlqen.
21 Kjo është pjesë e shoqërisë së lirë".

22 Po si mundet që të zhvillohet një debat në qoftë se
23 faktet themelore fshihen?

24 ZPS-ja i druhet konfrontimit me njerëzit e shtypit që i
25 bënë publike dhe vazhdojnë t'i bëjnë publike shqetësimin e

1 tyre bazuar në këto dokumente, të bashkëpunimit të ZPS-së, për
2 t'u përdorur fjalët e shtypit, në thonjëza.

3 ZPS-ja pra, bashkëpunimi i ZPS-së me ato që dyshohen për
4 vrasje dhe përdhunime dhe shpopullimin e detyruar të
5 popullsisë për të çuar përpara agjendën e vet.

6 Në të njëjtën kohë, ZPS-ja nuk thërret dëshmitarë nga
7 radhët e veta të shpjegojë dhe t'u kërkohet llogari për
8 çështjen se kush, si dhe përse ky material u lejua të kalonte
9 nga ZPS-ja në OVL UÇK dhe jo në një, jo në dy, por në tre
10 raste të ndryshme. ZPS-ja shtrëngon radhët e veta. Dhe e di se
11 njohuri e saj për atë proces mbetet në hije, mbrojtur nga
12 kontrolli nga kolegët e vet.

13 Pavarësisht se Prokurori i Specializuar i ka thënë
14 publikut në deklaratën hapëse se dokumentet u vodhën,
15 Prokuroria nuk ka kërkuar asnjë provë për ta mbështetur këtë
16 pohim apo ndonjë provë se në fakt çfarë ka ndodhur.

17 Ata nuk thonë asgjë për informacionin që përmban prova
18 materiale P00155 dhe përkthimi P00155-ET, që shprehimisht e
19 bën të qartë se disa gazetarë morën një kopeje të
20 ashtuquajturës "Dosjes së Hagës" drejtpërdrejtë nga, po citoj:
21 "Një burim në Zyrën e Prokurorisë në Hagë".

22 Kur Mbrojtja thotë "ka informacion se një punonjës me
23 emër që punon aktualisht në ZPS është implikuar në proces
24 përmes të cilit materialet mbërritën në zyrat e OVL UÇK-së",
25 ato nuk thonë asgjë dhe nuk kërkojnë asnjë provë për ta hedhur

1 poshtë. Pavarësisht nga hetimet që Prokurori i Specializuar
2 pretendon se kanë kryer në fjalën e tij hapëse, ZPS-ja nuk ka
3 dhënë si provë ndonjë raport të pavarur që të shfajësojë
4 stafin e vet si të përfshirë në rrjedhën e një dokumenti të
5 tillë. Ata nuk mund ta bëjnë këtë sepse nuk kanë një raport të
6 tillë, nuk e kanë.

7 Kur nuk ka vullnet apo prirje për t'i përballur ata në
8 shtyp të cilët nxorën në dritë, duke përdorur fjalët e tyre,
9 "bashkëpunimin e turpshëm" të ZPS-së dhe atyre të dyshuar për
10 krimet më të rënda, ZPS-ja refuzon njëkohësisht të lejojë të
11 vërtetën të dalë në shesh në lidhje me kush, si dhe përse ky
12 material doli nga zyrat e saja dhe përfundoi në OVL UÇK në
13 radhë të parë.

14 Përkundrazi, ZPS-ja sulmon, synon Hysni Gucatin dhe të
15 bashkakuzuarin e tij me këto akuza të sajuara në një procedim
16 pa viktima. Kjo është, për mendimin tonë, një procedim prej
17 frikacaku nga një zyrë Prokurorie frikacake.

18 Përkundrazi nga ana e tij, Hysni Gucati nuk është
19 frikacak. Ai është, ka qenë gjithnjë, i hapur, i ndershëm dhe
20 transparent. Dhe të hënën ai do të japë dëshmi dhe do t'i
21 përgjigjet çdo pyetjeje që do t'i bëhet.

22 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

24 Faleminderit, zoti Rees.

25 Do të rifillojmë punën të hënën, 6 dhjetor 2021, në orën

1 9.30, për të filluar çështjen e Mbrojtjes së Gucatit.

2 Këtu përfundojmë.

3 --- Seanca përfundon në orën 10.22

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25